

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *KOMUNA E RAHOVECIT*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *Nr i prokurimit 623-26-2856-2-1-1;*
Nr i brendshëm 623-26-015-2-1-1

Sa i përket tenderit për: *Hartimi i projekteve të ndryshme*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ENG IDEA SH.P.K. ; ARCH EMPIRE L.L.C. & GEOMETRI SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123 p.n.

(Adresa)

Suhareke

(Vendi)

23000

(Kodi postar)

+38349111592

(Numri Telefonit)

n/a

(Numri i Faks-it)

Beqir Ramdani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

engidea16@gmail.com

(Adresa elektronike)

08.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:



NUK APLIKOHET
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Datë 29.04.2026, njoftimi për kontratë të publikuar
Datë 30.06.2026, njoftimi për Proces verbal të hapjes së Tenderit
Datë 23.07.2026, njoftim mbi vendimin e AK si dhe Letrat standarde për OE
Datë 28.07.2026 Kërkese për Rivleresim
Datë 30.07.2026 Vendim i AK Komuna e Rahovecit

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kemi marr pjesë në hapjen e ofertave, kemi pranuar proces verbalin e hapjes në E-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Datë 28.07.2026 Kërkese për Rivleresim

Datë 30.07.2026 Vendim i AK Komuna e Rahovecit -Reufzim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP në

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 55 Menyra e komunikimit

Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60 Kriteret për dhenjen e kontratës

Neni 69 Aftësia teknike dhe/ose profesionale

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve

Neni 45.19 i RRPP-së

Neni 45.20 i RRPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 23.07.2026 AK KOMUNA E RAHOVECIT ka publikuar Njoftimin për Venidmin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Hartimi i projekteve të ndryshme dhe njekohesisht ka derguar edhe Leter standarde për eliminimin e grupit të OE ENG IDEA SHPK; ARCH EMPIRE LLC. & GEOMETRI SH.P.K. Kemi lexuar dhe analizuar me kujdes arsyeshmerin e dhene për eliminimin e grupit tone të OE-ve ku AK ka thënë po citoj:

- „Ju njoftojme se ju si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GEO) nuk i keni permbushur të gjitha kërkesat e percaktuara në Dosjen e Tenderit dhe

Njoftimin per Kontrate, perkatesisht kerkesat qe lidhen me kapacitetin tekni dhe profesional te stafit te propozuar”

- *“Pas analizimit dhe shqyrtimit te Ofertes Financiare te dorezuar nga GOE, Komisioni i Vleresimit ka vleresuar se ne oferten e dorezuar ne disa prozicioneve ju si GEO keni ofruar me cmime abnormalisht te uleta”*
- *„Ju njoftojme se ju si Grup i Operatoreve Ekonomike (GEO)nuk i keni permbushur te gjitha kerkesat e percaktuara ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin per Kontrate, perkatesisht kerkesat qe lidhen me kapacitetin tekni dhe profesional tek kerkesa e pajisjeve”*

Me eliminimin e Grupit te Operatoreve Ekonomike ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE LLC & GEOMETRI SH.P.K., Autoriteti Kontraktues – Komuna e Rahovecit – i hap rrugë vetes per te shperblyer me kontratë një Operator Ekonomik, oferta e te cilit rezulton te jetë më e shtrenjta në këtë procedurë te prokurimit (rreth 423 herë ose 42,302.00% më e shtrejtë). Per më tepër, pas shqyrtimit te dokumentacionit te ofertuesit te propozuar per kontratë, rezulton se ky OE është edhe i përgjegjshëm.

Përkundër argumenteve tona bindëse dhe te bazuara në dispozitat ligjore, te cilat trajtojnë secilin pretendim te ngritur nga ana jonë, AK nuk i ka marrë parasysh asnjërin nga faktet e ofruara dhe ka refuzuar kërkesën tonë, duke vepruar në mënyrë jo ligjore dhe duke cenuar integritetin e procedurës së prokurimit në trajtimin jo te barabartë te lëndës dhe përdorimin e standardeve te dyfishta te cilat bien ndesh me parimin bazë te LPP- trajtimin e barabartë te palëve.

Në vazhdim po i paraqesim pretendimet e ngritura ankimore:

Pretendimi 1: Lidhur me konstatimin për mungesën e nënshkrimit në CV-të e ekspertëve

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional, me arsyetimin se për ekspertin e elektroteknikës, z. Xhevdet Sejdiu, dhe ekspertin për hartimin e elaboratit të EMZ-së, z. Ramush Hajdari, janë dorëzuar CV të panënshkruara nga vetë ekspertët, ndonëse Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht "CV-në (të nënshkruar nga vetë pala)".

Ky konstatim është rezultat i një vlerësimi tepër formalist dhe nuk pasqyron gjendjen faktike te ofertës së paraqitur.

Në rastin konkret, ne si Grup i Operatoreve Ekonomik kemi dorëzuar te gjithë dokumentacionin që dëshmon kapacitetin teknik dhe profesional te ekspertëve te propozuar, përkatësisht diplomat, licencat profesionale, marrëveshjet e bashkëpunimit te nënshkruara nga ekspertët dhe ne si Grup i Operatoreve Ekonomik, letrat referente, si dhe CV-të e tyre.

Është e rëndësishme te theksohet se ekspertët kanë qenë realisht te angazhuar në projekt dhe këtë e dëshmojnë marrëveshjet e bashkëpunimit te nënshkruara nga te dyja palët, te cilat janë dorëzuar si pjesë e ofertës. Këto marrëveshje përbëjnë provë te drejtpërdrejtë te pranimit te angazhimit nga ekspertët dhe te vullnetit te tyre për te marrë pjesë në realizimin e kontratës.

Versionet e nënshkruara të CV-ve kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertës dhe janë nënshkruar në të njëjtën kohë me marrëveshjet e bashkëpunimit. Mirëpo, gjatë procesit të ngarkimit elektronik të dokumentacionit në platformën e prokurimit, për shkak të një gabimi teknik në përzgjedhjen e skedarëve, janë ngarkuar versionet e panënshkruara të CV-ve. Ky gabim është thjesht administrativ dhe nuk lidhet me mungesën e dokumentit apo me mungesën e nënshkrimit në momentin e përgatitjes së ofertës.

Përmbajtja e versioneve të panënshkruara dhe e versioneve të nënshkruara është plotësisht identike. Nuk ndryshon asnjë element i përvojës profesionale, kualifikimeve, licencave, referencave apo të dhënave personale të ekspertëve. I vetmi dallim është ekzistimi i nënshkrimit në versionin e duhur të dokumentit.

Prandaj, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me plotësim, ndryshim apo përmirësim të ofertës pas afatit për dorëzimin e saj, por vetëm me vërtetimin e ekzistencës së një dokumenti që ka qenë i përgatitur dhe i nënshkruar para dorëzimit të ofertës. Dorëzimi i versionit të nënshkruar të CV-së nuk ndryshon përmbajtjen e ofertës, nuk sjell ndonjë informacion të ri dhe nuk i krijon Operatorit Ekonomik ndonjë avantazh konkurrues ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë.

Në arsyetimin e vendimit, Autoriteti Kontraktues thekson së nënshkrimi i CV-së shërben për të konfirmuar saktësinë e të dhënave dhe pranimin e angazhimit nga eksperti. Megjithatë, ky qëllim është përmbushur tashmë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga secili ekspert, të cilat kanë vlerë juridike edhe më të madhe, pasi përfaqësojnë marrëdhënien kontraktuale ndërmjet Operatorit Ekonomik dhe ekspertit. Për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se mungesa e nënshkrimit në versionin e ngarkuar të CV-së ka lënë të paprovuar pranimin e angazhimit apo ekzistencën e kapacitetit teknik.

Për më tepër, ne si Grup i Operatoreve Ekonomik kemi përmbushur në substancë të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me këta ekspertë. Autoriteti Kontraktues në asnjë moment nuk ka kontestuar identitetin e tyre, kualifikimet profesionale, përvojën, licencat apo vlefshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit. E vetmja mangësi e konstatuar lidhet me mungesën e nënshkrimit në versionin e ngarkuar të dy CV-ve, e cila nuk ndikon në përmbajtjen e dokumenteve dhe nuk cenon në asnjë mënyrë konkurrencën apo trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Dsipozitat ligjore të prokurimit publik e bëjnë dallimin ndërmjet mungesës së një elementi thelbësor që ndikon në përmbajtjen e ofertës dhe një mangësie formale që nuk ndryshon substancën e saj. Sipas nenit 45.19 të RRPP-së, neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve pika 4 e cila thekson se: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.* Po ashtu sipas nenit 45.20 të RRPP-së ndër të tjera thekson se: *Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet*

si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me përshembull cilësinë ose kërkesat e përformancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual... Në rastin konkret mungesa e nënshkrimit nuk përbën ndryshim të kushtit material të aspektit të tenderit, kjo përbën devijim të vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat dhe kushtet fillestare të DT, andaj duhet të trajtohet në pajtim me nenin përkatës pasi që nuk mungon eksperti, nuk mungon CV-ja, nuk mungojnë kualifikimet dhe as dokumentet që dëshmojnë angazhimin e ekspertëve. Për rrjedhojë, shpallja e ofertës si e papërgjegjshme vetëm për shkak të ngarkimit të një versioni të panënshkruar të CV-ve është një masë joproporcionale, e cila nuk është në përputhje me qëllimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe bie ndesh me parimet themelore të LPP-së dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Për të eliminuar çdo paqartësi lidhur me këtë çështje, ankuesi bashkëngjit:

- versionet origjinale të CV-ve të nënshkruara nga të dy ekspertët, të cilat kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertës;
- deklaratat e nënshkruara nga secili ekspert, me të cilat konfirmohet se CV-të janë nënshkruar në të njëjtën datë me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe se versioni i panënshkruar është ngarkuar gabimisht gjatë procesit elektronik të dorëzimit të ofertës.

Këto dokumente nuk përbëjnë plotësim apo ndryshim të ofertës, por vetëm provojnë një fakt ekzistues në momentin e dorëzimit të saj. Për rrjedhojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues për ta shpallur ofertën të papërgjegjshme për këtë arsye nuk mbështetet në një vlerësim material të kapacitetit teknik dhe profesional, por vetëm në një mangësi formale që nuk ka ndikuar në përmbajtjen, vlefshmërinë apo konkurrueshmërinë e ofertës.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar për të dëshmuar përmbushjen e kapacitetit teknik dhe profesional të ekspertëve të propozuar, përkatësisht diplomat, licencat profesionale, marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet ekspertëve dhe Operatorit Ekonomik, letrat referente, si dhe CV-të e tyre.

Duhet të theksohet se ekspertët, përmes CV-ve të paraqitura, kanë dëshmuar se i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit lidhur me kualifikimet dhe përvojën profesionale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, pasi nuk ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore që rregullojnë sqarimin e tenderëve. Në këtë rast, është anashkaluar procedura e sqarimit e paraparë në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Neni 10.1 i këtij udhëzuesi parashikon se, në rastet kur në CV mungojnë informata të caktuara të kërkuara, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime nga Operatori Ekonomik.

Në rastin konkret, kur CV-të e dorëzuara nuk përmbajnë të gjitha informatat e kërkuara Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë informata sqaruese të cilat lidhen

me mungesën e informatës së kërkuar, e cila nuk ndikon në përmbajtjen, kualifikimin apo përvojën profesionale të ekspertëve.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të zbatojë procedurën e sqarimit të tenderit në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 10.1 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, në vend që ta konsiderojë këtë mangësi si bazë për eliminimin e Operatorit Ekonomik.

Praktika krahasuese dhe parimet e proporcionalitetit

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues nuk është në përputhje me parimet e zhvilluara në praktikën evropiane të prokurimit publik lidhur me dallimin ndërmjet një mangësie formale dhe ndryshimit material të ofertës.

Në praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian është theksuar vazhdimisht se autoritetet kontraktuese duhet të bëjnë dallim ndërmjet dokumenteve që vetëm dëshmojnë një gjendje ekzistuese në momentin e dorëzimit të ofertës dhe dokumenteve që do të krijojnë ose ndryshojnë përmbajtjen e ofertës pas skadimit të afatit.

Në çështjen **C-336/12 Manova**, Gjykata ka pranuar se, në rrethana të caktuara, mund të kërkohej paraqitja ose sqarimi i dokumenteve që dëshmojnë një fakt objektiv që ka ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertave, për sa kohë që kjo nuk rezulton në paraqitjen e një oferte të re ose në ndryshimin e përmbajtjes së ofertës.

Po kështu, në çështjet **C-387/14 Esaprojekt** dhe **C-131/16 Archus**, Gjykata ka bërë dallimin ndërmjet sqarimit të dokumenteve ekzistuese dhe plotësimit të palejuar të ofertës, duke theksuar se nuk lejohet ndryshimi i elementeve thelbësore të ofertës, por se një autoritet kontraktues duhet të vlerësojë nëse dokumenti i paraqitur shërben vetëm për të konfirmuar një gjendje faktike që ka ekzistuar në kohën e dorëzimit të ofertës.

Këto parime janë plotësisht të zbatueshme në rastin konkret.

Operatori Ekonomik nuk kërkon të ndryshojë ofertën, të propozojë ekspertë të rinj, të ndryshojë kualifikimet, përvojën profesionale, licencat apo ndonjë element tjetër të ofertës. Përkundrazi, kërkohej vetëm të merret në konsideratë fakti se versionet e nënshkruara të CV-ve kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertës dhe se për shkak të një gabimi gjatë ngarkimit elektronik është bashkëngjitur versioni i panënshkruar i të njëjtit dokument.

Përmbajtja e të dy versioneve është identike. Nuk ndryshon asnjë e dhënë mbi ekspertët, nuk shtohet asnjë kualifikim, nuk ndryshohet asnjë përvojë profesionale dhe nuk krijohet asnjë avantazh konkurrues për Operatorin Ekonomik. Në këto rrethana, marrja në konsideratë e versioneve të nënshkruara të CV-ve nuk do të përbënte plotësim të ofertës, por vetëm konfirmim të një fakti ekzistues në momentin e dorëzimit të saj.

Për më tepër, vetë qëllimi i kërkesës për nënshkrimin e CV-së – konfirmimi i pranimit të angazhimit nga eksperti – është përmbushur tashmë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga secili ekspert dhe Operatori Ekonomik, të cilat janë dorëzuar brenda afatit të ofertimit. Për këtë arsye, mungesa e nënshkrimit në versionin e ngarkuar të CV-së nuk cenon as besueshmërinë e ofertës, as përmbushjen e kapacitetit teknik dhe profesional.

Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues është joproporcional dhe formalist, pasi një mangësi që nuk prek substancën e ofertës është trajtuar sikur të ishte mungesë e vetë kapacitetit teknik. Një qasje e tillë nuk është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës efektive dhe trajtimit të barabartë që udhëheqin procedurat e prokurimit publik.

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues në përgjigjen e dhënë në Kërkesën për Rishqyrtim se mungesa e nënshkrimit në CV-të e ekspertëve z. Xhevdet Sejdiu dhe z. Ramush Hajdari përbën mosplotësim të kriterit të kapacitetit teknik dhe profesional.

Autoriteti Kontraktues ka bërë një interpretim të gabuar të natyrës së kërkesës së Dosjes së Tenderit, duke e trajtuar kërkesën formale si kriter të kualifikimit, pasi që mungesën e nënshkrimit e ka konsideruar si mosplotësim të kriterit material dhe duke e përdorur këtë mangësi si bazë për eliminimin e Operatorit Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues e ka trajtuar mungesën e nënshkrimit në dy CV-të e ekspertëve, z. Xhevdet Sejdiu dhe z. Ramush Hajdari, si mosplotësim të një kriteri të kapacitetit teknik dhe profesional dhe, mbi këtë bazë, ka eliminuar ofertën. Ky përfundim nuk është i drejtë, pasi duhet bërë dallimi ndërmjet **kriterit material të kualifikimit të ekspertit dhe një elementi formal të dokumentit të paraqitur për dëshmimin e këtij kriteri.**

Në rastin konkret, CV-të e të dy ekspertëve kanë qenë të dorëzuara, ndërsa janë dorëzuar edhe diplomat, licencat profesionale, letrat referente dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ekspertët. Pra, nuk ka munguar as eksperti, as kualifikimi, as përvoja profesionale dhe as dëshmia për angazhimin e tyre. E vetmja mangësi e konstatuar ka qenë mungesa e nënshkrimit në CV.

Autoriteti Kontraktues arsyeton se Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht “CV-në të nënshkruar nga vetë pala” dhe se mungesa e nënshkrimit përbën mosplotësim të kriterit, mirëpo ky arsyetim nuk mund të pranohet, pasi fakti që është kërkuar një dokument i nënshkruar nuk nënkupton se çdo mangësi formale në atë dokument përbën domosdoshmërisht mosplotësim të kriterit të kualifikimit.

Në rastin konkret duhet të vlerësohet qëllimi i kërkesës për nënshkrim dhe nëse mungesa e tij ka ndikuar realisht në përmbushjen e kapacitetit teknik dhe profesional. Vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar se qëllimi i nënshkrimit është konfirmimi i saktësisë së të dhënave dhe pranimi të angazhimit nga eksperti, ndërsa këto elemente janë dëshmuar përmes dokumentacionit të dorëzuar në ofertë, veçanërisht përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga ekspertët, të cilat dëshmojnë qartë vullnetin e tyre për angazhim, si dhe përmes diplomave, licencave, referencave dhe dokumenteve të tjera që dëshmojnë kualifikimin dhe përvojën profesionale.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është i gabuar edhe në pjesën ku ngatërrohet **“mungesën e informatës” me “mungesën e dokumentit”**, dhe rrjedhimisht mungesën e nënshkrimit e trajton si mosplotësim të kriterit. Në ofertë CV-të e ekspertëve kanë qenë të dorëzuara dhe nuk ka munguar asnjë informacion thelbësor lidhur me identitetin, kualifikimin, përvojën, licencat, referencat apo angazhimin e tyre. E vetmja mangësi ka qenë mungesa e nënshkrimit në CV, e cila përbën vetëm një element formal të dokumentit të dorëzuar dhe jo mungesë të dokumentit apo të kapacitetit të kërkuar. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues është dashur ta trajtojë këtë çështje në kuadër të dispozitave për sqarimin e tenderëve dhe jo ta përdorë automatikisht si bazë për eliminimin e ofertës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka gabuar kur ka barazuar “CV të panënshkruar” me “mosplotësim të kriterit të kapacitetit profesional”. Nënshkrimi është një element formal i dokumentit dhe mungesa e tij nuk ka ndryshuar asnjë element material të ofertës.

Po ashtu, është i gabuar arsyetimi se neni 59 i LPP-së dhe dispozitat për sqarimin e tenderëve nuk mund të aplikohen. Në këtë rast nuk kërkohej krijimi i një kualifikimi të ri apo dorëzimi i një dokumenti që nuk ka ekzistuar, por vetëm sqarimi i një mangësie në një dokument që ka qenë pjesë e ofertës. Sipas nenit 10 të Udhëzuesit përkatës për sqarimin e tenderëve, kur në CV mungojnë informata të kërkuara, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime nga Operatori Ekonomik.

Edhe neni 72, paragrafi 3 i LPP-së nuk e përjashton një sqarim të tillë, pasi në rastin konkret ekzistenca e CV-ve dhe e ekspertëve ka qenë e fiksuar para skadimit të afatit të ofertimit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Dokumentet e nënshkruara të paraqitura me kërkesën për rishqyrtim nuk kanë krijuar një kapacitet të ri, por kanë shërbyer vetëm për të dëshmuar ekzistencën e një fakti para afatit të ofertimit.

Në këto rrethana, mungesa e nënshkrimit në CV përbën një mangësi formale dhe jo një devijim material, pasi nuk ka ndikuar në kualifikimin, përvojën, licencimin apo angazhimin e ekspertëve. Për këtë arsye, eliminimi i Operatorit Ekonomik vetëm mbi këtë bazë është joproporcional dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe dispozitat përkatëse të RRPP-së dhe Udhëzuesit për sqarimin e tenderëve.

Pretendimi 2: Lidhur me ofrimin me çmime abnormalisht të ulëta në pozicionet e caktuara

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar në aspektin faktik dhe juridik, pasi nuk ka bërë një vlerësim të plotë dhe objektiv të sqarimeve të dorëzuara nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë lidhur me pretendimin për çmim jo normalisht të ulët. Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka paraqitur një arsyetim të detajuar teknik dhe profesional, duke shpjeguar metodologjinë e llogaritjes së çmimeve, strukturën e kostove, organizimin e realizimit të shërbimeve, përvojën e mëparshme dhe arsyet pse pozicionet e kontestuara nuk mund të trajtohen si shërbime të pavarura, por si pjesë përbërëse e projekteve të përgjithshme. Megjithatë, nga vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk rezulton se këto argumente janë analizuar individualisht dhe nuk është dhënë një arsyetim teknik apo juridik që do të rrëzonte pretendimet tona.

Në sqarimet e dorëzuara është argumentuar se pozicionet e kontestuara, si projektimi i ashensorëve, nyjeve rrugore, elaboratet e shpronësimit, rezervuarëve të ujit, kaptazheve, impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, urave, nënkalimeve dhe objekteve të tjera infrastrukturore, nuk përbëjnë shërbime të pavarura, por janë elemente integrale të projektit bazë. Për këtë arsye, çmimet për këto elemente janë përfshirë në çmimet e përgjithshme të projektimit të objekteve dhe infrastrukturës. Kjo metodologji është në përputhje me praktikën profesionale të projektimit, ku projekti trajtohet si një tërësi funksionale dhe jo si një grup shërbimesh të ndara artificialisht.

Për më tepër, çmimet e ofertës tonë kanë ardhur si pasojë që dokumentet e tenderit përmbajnë një metodologji të paqartë të ndërtimit të paramasës dhe parallogarisë, ku elemente që janë pjesë integrale e të njëjtit projekt janë ndarë në njësi të ndryshme matëse, si për copë, për metër linear, për metër katror apo për metër kub. Meqenëse në këtë fazë nuk janë të njohura parametrat teknikë, dimensionet, kapacitetet dhe kompleksiteti i këtyre elementeve për të cilat pretendohet se kanë çmime të ulëta, OE në çmimin e ofruar është bazur në ndarjen e elementeve përkatës, duke i vlerësuar sipas çmimit të projektimit në baze të normave dhe standardeve ku teresia e këtyre elementeve përbën çmimin final të projektimit në tërësinë e elementeve konstruktive (psh. është e pakuptimt të bëhet ndarja e projektimit të një ashensori

apo të cilit do element tjetër të objektit kur nuk dihen asnjë parametër i tij dhe të kërkohet çmim për copë e aq më tepër të vlerësohet si çmim jo normalisht i ulët). Duke pasur parasysh këto ndarje të elementeve tërësia e projektimit për sipërfaqe për m² i ofruar nga GOE i ynë është plotësisht brenda mesatares së çmimeve të tregut, andaj duke pasur parasysh këtë fakt nuk është e mundur të përcaktohet dhe te jepet vlerësimi se çmimi i elementeve të specifikuar është i ulët.

Metodologjia e përdorur nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomik, duke përfshirë këto elemente në çmimet e përgjithshme të projektimit, është profesionale, logjike, rrjedhë nga një proces zbërthimi i çmimit total sipas normave të projektimit (e sqaruar në detaje në përgjigjen e dhënë për AK) dhe ekonomikisht e arsyeshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë analizë dhe nuk ka provuar në asnjë moment se çmimet e ofruara e bëjnë të pamundur realizimin e kontratës apo se Grupi i Operatorëve Ekonomik nuk posedon kapacitetet teknike, profesionale dhe organizative për përmbushjen e obligimeve kontraktuale. Përkundrazi, në sqarimet tona janë paraqitur dëshmi konkrete për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme, përfshirë kontrata të realizuara për vetë Komunën e Rahovecit, ku shërbime të njëjta janë kryer me çmime konkurruese, pa asnjë mangësi në cilësinë e projektimit apo në përmbushjen e obligimeve kontraktuale. Kjo dëshmon se çmimet e ofruara nuk janë spekulative, por bazohen në praktika dhe përvojë reale në të kaluarën me vet AK-në dhe në organizimin efikas të punës në ndërmarrjen tonë.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me praktikën e tij të mëparshme. Në procedurën e prokurimit me numër 623-23-321-2-1-1, i njëjti Autoritet Kontraktues kishte konstatuar se, në kontratat për shërbime projektuese ku nuk dihen sasi të indikative dhe kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i ulët i poentuar, çmimet individuale të pozicioneve nuk mund të analizohen të shkëputura nga oferta në tërësi, por duhet të vlerësohen në kuadër të strukturës së përgjithshme të ofertës. Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues ka ndjekur një qasje krejtësisht të kundërt, pa dhënë asnjë arsyetim për ndryshimin e praktikës së vet administrative, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë, sigurisë juridike dhe pritshmërisë legjitime të operatorëve ekonomik.

Në vendin tonë nuk ka legjisllacion specifik për përcaktimin e çmimeve referente ku mund të bazohen dhe të krahasohen çmimet e ofruara të shërbimeve profesionale për projektim. AK në letrën standarde ka deklaruar që komisioni vlerësimit pas analizës së tregut ka konstatuar se oferta jonë në një numër të konsiderueshëm të pozicioneve përban çmime jo normalisht të ulëta. Shtrohet pyetja ?? Në bazë të cilës analizë të tregut ka vlerësuar Komisioni nga AK, sepse raporti i komisionit nuk përmban ndonjë analizë të çmimeve?!

Si e anashkaloj AK - Komisioni i vlerësimit plotësisht përgjigjen, analizë tonë dhe argumentet e ofruara, plotësisht profesionale dhe të argumentuara me praktika të mëhershme qoftë ato të ndërmarrjes sonë me AK, Apo edhe praktikat e AK me OE tjerë.

Praktika e fundit e vet AK me OE të rekomanduar për kontratë, i cili në 54 pozicione ka pasur çmime të ngjashme apo shumëfish më të ulëta se oferta jonë, por aso kohe AK nuk i kishte vlerësuar si çmime jo normalisht të ulëta!. Pra AK është duke përdorur standarde të dyfishta të vlerësimit. Me një verifikim të thjeshtë konstatohet se OE i rekomanduar për kontratë ka marrë referencë pozitive nga AK – Komuna e Rahovecit edhe pse oferta e tij ka qenë me çmime shumëfish më të ulëta.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk është i mbështetur në një analizë të plotë të fakteve dhe provave të paraqitura, nuk përmban arsyetim teknik dhe juridik, duke pasur parasysh edhe përbërjen e komisionit vlerësues në aspektin profesional dhe si i tillë bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, kërkojmë që

vendimi të anulohet dhe oferta jonë të rivlerësohet në përputhje me sqarimet e dorëzuara dhe me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi 3: Lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e pajisjeve

Ne letren standarde për eliminim AK ka deklaruar si ne vijim po citoj:

„Kërkesa 6 Një (1) PAJISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK – Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me kamerë në controller-terminal, me opcion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, mundësinë e modelimit 3D dhe piketimi real view me kamerë.

është kërkuar si dëshmi dokumentare

Dëshmia 6. Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësisë (DUD doganor apo faturë blerjeje) ose marrëveshje për qira e nënshkruar tek noteri. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i pajisjes.

Grupi i Operatorëve ka paraqitur pajisjen hi-target V600I, e cila pajisje nuk plotëson kushtin **"me opcion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me mundësinë e modelimit 3D"**.

Sipas prodhuesit, pajisja e paraqitur ka mundësi të matjes me laser, por jo edhe rilevim me fotogrametri dhe modelimin 3D. Kamera që posedon pajisja shërben vetëm për piketim-orientim në natyrë, ndërsa jo për fotogrametri.

Prandaj, duke u bazuar në **nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur që ofertën e Operatorit Ekonomik ta konsiderojë si **Ofertë të Papërgjegjshme.**”

Eshte konstatim plotesisht i pasakt sepse ne dosjen tone ne kemi ofruar paisjet në marrveshjen e perbashket me ENG GEO GRUP si ne vijim :

Pajisje Gjeodezike SLAM LIDAR & GNSS V700S Multi-Frekuece dhe Full Constellation me 1408 sinjale satelitore, me laser të integruar për matje, me 3 kamera të integruara në kokë si dhe GNSS Marrës me IMU për matje Tilt të integruar për matje njëkohësisht si LiDAR dhe si Rover GPS GNSS me tablet Robust 8 inch, si dhe pako me dy softuera për GPS GNSS dhe LIDAR set Softueri për Post Procesim të dhënave në zyre dhe rafinim të tyre në re të pikave ose PointCloud.

Pajisje Gjeodezike HI TARGET GPS GNSS V600L Rover me 1408 sinjale satelitore, me Laser dhe kamerë të integruar në kokë-resiver dhe në kontrollor, me pamje reale të terrenit duke targetuar me shenjë në pikë vrojtimi dhe pamje reale me opcion të ACAD gjatë piketimit me laser dhe kamerë set.

Pajisje për aplikim në Gjeodezi-Fluturake pa Pilot DRON DJI Matrice 4 Enterprise Series me 2 kamera të integruara 48 MP dhe RTK Modul të integruar dhe RC Plus kontrollor. Softuer Gjeodezik- HI-TARGET PPK GO. Software për post-procesim, barazim, orientim të brendshëm dhe projektim të aero-imazheve të dronit DJI dhe sinjalit PPK RTK për post-barazim të rrugës së fluturimit për përpunim të mëtejme të ortofotos dhe modelit 3D set pako.

Një (1) PAJISJE GJEODEZIKE HI TARGET GPS GNSS V600 L ROVER me minimum 1408 sinjale satelitore, me Laser dhe kamerë të integruar në kokë-resiver, controller Handy me kamerë në controller-terminal, me opcion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, mundësinë e modelimit 3D dhe piketim real view me kamerë.

Pajisje Gjeodezike TS - Stacion Total HI-TARGET Robotic HTS 820 2" Set Pako One Pole Solution me 360 Prizem Hybrid Tracking, Kamerë për rilevim 360 shkallë panorame, GNSS Box me UHF dhe IMU për konektim në KOPOS ose Baze dhe Rover dhe Matje Optike të pjerrisë Tilt deri në 60 shkallë, si dhe tablet 8 inch set me dy softuer.

Se pari, komisioni i vleresmit ne perberjen qe ka pasur nuk kupton fare nga keto paisje dhe nuk ka ofruar ndonje dokument te vertetuar nga ndonje ekspert i fushes apo ndonje krahasim i specifikave teknike te paisjeve tona te prezentuara me ato ne kerkeses ne dosjes! Konstatimi eshte plotesoisht jo i drejte dhe i paqendrueshem.

Me nje krahasim shume te thjeshte keni tabelen ne vijim:

N r.	Kërkesa në FDT	Pajisja e ofruar	Specifikimet e ofertës / Katalogut teknik	Vlerësimi
5.1	Një (1) dron profesional për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik	DJI Matrice 4 Enterprise (Thermal)	Dron profesional Enterprise për fotogrametri, rilevim dhe inspektim.	 Plotësohet
5.2	Kamerë digjitale minimum 40 MP	DJI Matrice 4 Enterprise	Pajisja ofrohet me 3 kamera të integruara 48 MP , duke tejkaluar kërkesën minimale prej 40 MP.	 Plotësohet
5.3	Mundësi matjeje me PPK	DJI Matrice 4 Enterprise + HI-TARGET PPK GO	Droni është i pajisur me RTK Module , ndërsa post-procesimi realizohet me HI-TARGET PPK GO Software , duke mundësuar përpunimin PPK të trajektorës së fluturimit.	 Plotësohet
5.4	Softuer për procesim PPK	HI-TARGET PPK GO Software	Softuer profesional për post-procesim, barazim, orientim të brendshëm, përpunim të ortofotos dhe modelit 3D.	 Plotësohet
5.5	Certifikatë AAC për operatorin e dronit	Certifikata AAC	Në ofertë është paraqitur certifikata valide e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për operatorin e dronit.	 Plotësohet
6.1	GPS GNSS RTK me minimum 1408 kanale	HI-TARGET V600L Laser RTK	Pajisja posedon 1408 GNSS Channels .	 Plotësohet
6.2	Dual kamerë në receiver	HI-TARGET V600L	Pajisja posedon Front Camera dhe Bottom Camera .	 Plotësohet
6.3	Controller Handy me kamerë	HI-TARGET V600L	Controller profesional me sistem Android dhe funksione vizuale për rilevim dhe stakeout.	 Plotësohet
6.4	Rilevim 3D me fotografi (fotogrametri)	HI-TARGET V600L	Mbështet Image Measurement, Visual Laser Targeting dhe AR Stakeout .	 Plotësohet
6.5	Matje me laser	HI-TARGET V600L	Pajisja përfshin Laser Measurement me saktësi deri në 2 cm.	 Plotësohet
6.6	Mundësi modelimi 3D	HI-TARGET V600L + V700S	Përmes Hi-Survey dhe Hi-LiDAR realizohet modelimi 3D dhe përpunimi i Point Cloud.	 Plotësohet
6.7	Piketim Real View me kamerë	HI-TARGET V600L	Pajisja mbështet Real Scene CAD Stakeout, AR Stakeout dhe Visual Laser Targeting .	 Plotësohet
7.1	Një (1) Pajisje Gjeodezike Total Station Robotic + GPS + Hybrid	HI-TARGET HTS-820 Robotic Total Station	Total Station Robotic 2", Hybrid Tracking, 360° Prism, GNSS Box, IMU, UHF, Base/Rover, KOPOS, Optical Tilt deri 60°, Tablet 8".	 Plotësohet

Pajisje shitesë të ofruara (mbi kërkesat minimale)

Pajisja	Karakteristikat kryesore	Vlera e shtuar
HI-TARGET V700S SLAM LiDAR & GNSS	1408 kanale GNSS, LiDAR, 3 kamera, IMU, Laser, Point Cloud, SLAM, Tablet 8", Hi-LiDAR Software.	Tejkalon kërkesat minimale të FDT-së duke mundësuar skanim 3D, modelim arkitektonik, përpunim të reve të pikave (Point Cloud), DEM, konture, analiza volumetrike dhe post-procesim të avancuar.

Nga krahasimi i kërkesave të FDT-së me pajisjet dhe dokumentacionin teknik të paraqitur në ofertë rezulton se:

Kërkesa 5 është plotësisht e përmbushur, pasi operatori ekonomik ka ofertuar një dron profesional **DJI Matrice 4 Enterprise**, me **kamera 48 MP**, modul **RTK**, **HI-TARGET PPK GO Software** për post-procesim PPK dhe ka paraqitur **certifikatën valide të operatorit të dronit të lëshuar nga AAC**.

Kërkesa 6 është plotësisht e përmbushur, pasi **HI-TARGET V600L** i plotëson të gjitha karakteristikat minimale të kërkuara dhe ofron funksionalitete shtesë si **Laser Surveying, Visual Laser Targeting, AR Stakeout, Real Scene CAD Stakeout dhe modelim 3D**.

Kërkesa 7 është plotësisht e përmbushur, pasi është ofertuar **HI-TARGET HTS-820 Robotic Total Station Hybrid**, i cili përfshin të gjitha komponentët e kërkuar: **Robotic Total Station, GNSS Box, Hybrid Tracking, IMU, UHF, Base/Rover dhe integrim me KOPOS**.

Konkluzion: Bazuar në dokumentacionin teknik të dorëzuar, ofertuesi ka dëshmuar përmbushjen e **Kërkesave 5, 6 dhe 7** të Dosjes së Tenderit, ndërsa pajisja shtesë **HI-TARGET V700S SLAM LiDAR & GNSS** përfaqëson një kapacitet teknik shtesë që tejkalon kërkesat minimale të autoritetit kontraktues.

Kjo tregon se AK ka pasur për qellim eliminimin e grupit të OE për të arritur të vetmin qellim shprehshëm me kontratë një grup tjetër të OE jo vetëm që është me i shtrejtë por edhe nuk është i përgjeshëm.

Kerkojme nga AK të rivlerësojë pajisjet tona të paraqitura në ofertë nëse ka paqartësi rreth tyre mund të kerkojë informata shtesë në përputhje me rregullorret dhe udhëzuesin e LPP-ne, por jo të jep konstatime të pasakta dhe jo profesionale si në këtë rast.

Pretendimi 4: Komisioni për vlerësimin e ofertave nuk ka marrë parasysh fare dokumentacionin e ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë Grupi i OE: PROing&Partners SH.P.K. & GEOCAD Group SH.P.K.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.5. Një Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Elektroteknikës ose master, me përvojë pune në projektim min. 3 vite pas diplomimit;

2.5. Diplomati përkatës – Kopje; Kontrata e rregulltë e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, nëse prezantoni marrëveshje për projektin, marrëveshja duhet të jetë e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; Një deklaratë

me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, për pikën 2.1; Staf profesional që kërkohen Inxhinier/ekspert të jenë të licencuar nga OIEK sipas legjislacionit në fuqi;

Grupi i Operatorëve Ekonomikë PROing&Partners SH.P.K. & GEOCAD Group SH.P.K., për përmbushjen e kësaj kërkesë, ka propozuar z. Dukagjin Ramqaj, duke bashkëngjitur diplomën, licencën, kontratën, CV-në dhe referencat.


Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nënshkrimi në CV dhe nënshkrimi në kontratë janë dukshëm të ndryshme, edhe pse të dy dokumentet është dashur të jenë të nënshkruara nga vetë z. Dukagjin Ramqaj, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Dallimet e qarta ndërmjet nënshkrimeve krijojnë dyshime serioze mbi autenticitetin e dokumenteve të paraqitura dhe nuk lejojnë të konstatohet se të dy dokumentet janë nënshkruar nga i njëjti person.

Për të mbështetur këtë pretendim, bashkëngjisim kopjet e nënshkrimeve të vendosura në CV dhe në kontratë, nga të cilat vërehen qartë dallimet ndërmjet tyre, duke dëshmuar se ato nuk përkojnë dhe nuk mund të konsiderohen si të njëjtit person, rrjedhimisht permban elemente të manipulimit të nënshkrimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i OE nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit, pasi nuk është dëshmuar në mënyrë të besueshme se CV-ja dhe kontrata janë nënshkruar nga vetë eksperti i propozuar, siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.

Foto 1 -Nenshkrimi ne kontrate

PUNËMARRËSI




Dukagjin Ramqaj
Mr. Elektroteknikës

Dukagjin Ramqaj

Digitally signed by Dukagjin Ramqaj
DN: cn=Dukagjin Ramqaj, o=AL,
ou=Ministria e Energjitikës dhe Ushtrisë
Elektrike, ou=Licenca AE-0002,
email=dramqaj83@gmail.com
Date: 2018.05.05 13:52:36 +0200

Foto 2 – Nenshkrimi ne CV



Pretendimi 5: Komisioni për vlerësimin e ofertave nuk ka marr parasysh fare dokumentacionin e ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë Grupi i OE: PROing&Partners SH.P.K. & GEOCAD Group SH.P.K.

2.7. Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor, me përvojë pune profesionale min. 3 vite pas diplomimit;

2.9. Një ekspert me licencë për hartimin e elaborative të VNM – së, me përvojë pune profesionale min. 3 vite pas diplomimit;

2.5. Diplomati përkatëse – Kopje; Kontrata e rregullt e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, nëse prezantoni marrëveshje për projektin, marrëveshja duhet të jetë e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar

dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, për pikën 2.1; Staf profesional që kërkohen Inxhinier/ekspert të jenë të licencuar nga OIEK sipas legjislacionit në fuqi;

Lidhur me kërkesat 2.7 dhe 2.9 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

2.7. Një Inxhinier të Gjeodezisë ose Bachelor, me përvojë pune profesionale minimum 3 vite pas diplomimit;

2.9. Një ekspert me licencë për hartimin e Elaboratit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), me përvojë pune profesionale minimum 3 vite pas diplomimit.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë PROing&Partners SH.P.K. & GEOCAD Group SH.P.K., për përmbushjen e këtyre kërkesave, ka propozuar: z. Shaban Hoti – Inxhinier i Gjeodezisë, për pozitën sipas pikës 2.7; z. Adnan Elshani – për pozitën sipas pikës 2.9, duke bashkëngjitur diplomën, kontratën, CV-në dhe referencat.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se as z. Shaban Hoti dhe as z. Adnan Elshani nuk janë të licencuar nga OIRK, ndonëse Dosja e Tenderit e ka përcaktuar qartë se stafi profesional i kërkuar duhet të jetë i licencuar nga OIRK sipas legjislacionit në fuqi.

Mungesa e kësaj licence përbën mosplotësim të një kërke të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, pasi licencimi është kërkuar shprehimisht si kriter i kualifikimit për stafin profesional. Përkundër kësaj mangësie, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave e ka konsideruar ofertën e Grupit të OE si të përgjegjshme dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, pa konstatuar këtë mospërmbushje.

AK, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka përdorur standarde të dyfishta në vlerësimin e dokumentacionit të OE-ve, duke favorizuar OE-në e rekomanduar për kontratë. Sipas kërkesës 2, neni 9.1 & 9.2 i FDT-së, stafi profesional i kërkuar, përkatësisht inxhinierët/ekspertët, duhej të ishin të licencuar nga Oda e inxhinierëve - OIEK, sipas legjislacionit në fuqi. Licencimi nga OIEK ka qenë kërkesë e qartë dhe kërkesë e detyrueshme në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në përgjigjen e dhënë ndaj kërkesës për rishqyrtim, AK ka ndryshuar dhe devijuar kuptimin e kësaj kërke, duke e anashkaluar në tërësi kushtin për licencim nga OIEK. Në këtë mënyrë, AK ka përdorur standarde të dyfishta, një standard për OE-në tonë, duke e eliminuar për mungesë të nënshkrimit në CV, ndërsa për OE-në e rekomanduar për kontratë nuk ka zbatuar të njëjtin standard, ndonëse për dy anëtarët e stafit profesional të kërkuar nuk janë dorëzuar licencat nga OIEK, siç kërkohej shprehimisht në dosjen e tenderit.

Prandaj, qëndrimi i AK-së rezulton në zbatim të pabarabartë të kërkesave të dosjes së tenderit, pasi për OE-në tonë është zbatuar në mënyrë strikte një kërkesë formale, ndërsa për OE-në e rekomanduar për kontratë është toleruar mungesa e një dokumenti të kërkuar.

Pretendimi 6: lidhur me çmimin e lartë të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahovecit, me veprimet e ndërmarra gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke pasur si rezultat favorizimin dhe rekomandimin për dhënie të kontratës operatorit ekonomik PROing & Partners

SHPK & GEOCAD Group SH.P.K., pa vlerësuar në mënyrë objektive dhe ligjore aspektin e çmimit të ofertës.

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka cenuar qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik, të përcaktuar në nenin 1, si dhe parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të përcaktuar në nenin 6 të LPP-së, pasi nuk ka marrë fare në konsideratë faktin se çmimet e ofertuara nga operatori ekonomik i rekomanduar janë dukshëm mbi çmimet reale të tregut.

Njëkohësisht, është shkelur edhe Rregullorja për Prokurimin Publik, konkretisht neni 4 "Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit", paragrafi 4.1, pika (c), e cila obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut.

Në rastin konkret, çmimet e ofertuara nga operatori ekonomik i rekomanduar janë më të larta krahasuar me çmimet e zakonshme të tregut në Republikën e Kosovës, duke krijuar një dëm potencial ndaj buxhetit publik dhe duke rrezikuar përdorimin joekonomik të fondeve publike.

Për ilustrim, në praktikën e tregut të Republikës së Kosovës, shërbimet e projektimit të objekteve të ndërtimit, duke përfshirë të gjitha fazat e projektimit (projektin ideor dhe projektin kryesor), realizohen zakonisht me një çmim prej 6–10 euro/m² përfshire shqyrtimet gjeomekanike.

Në anën tjetër, operatori ekonomik i rekomanduar ka ofertuar:

Projektin ideor me çmim 2.90 euro/m²; dhe

Projektin kryesor me çmim 11.90 euro/m².

(pa u përfshire shqyrtimet gjeomekanike të cilat janë të llogaritura në pos. të vecante)

Si rezultat, çmimi total për projektin ideor dhe projektin kryesor arrin në 14.80 euro/m², që tejkalon ndjeshëm intervalin e çmimeve të tregut prej 6–10 euro/m².

Ky dallim i konsiderueshëm dëshmon se Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të siguruar se kontrata lidhet me një çmim që reflekton vlerën reale të tregut, duke vepruar në kundërshtim me nenin 4.1(c) të Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe mbrojtjes së interesit publik të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Përkundër argumenteve tona bindëse lidhur me përshkrimin dhe arsyetimin e çmimeve për sigurimin e shërbimeve që do të ofrohen, si dhe praktikës së ndjekur nga vetë Autoriteti Kontraktues në kontratat e mëparshme për shërbime të së njëjtës natyrë, AK ka vendosur të veprojë në kundërshtim me dispozitat e RRPP-së, përkatësisht nenin 41.10.

Po ashtu, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë konsistent me praktikën e ndjekur në procedurat dhe kontratat paraprake, duke mos e trajtuar në mënyrë të arsyetuar dhe konkrete justifikimin e çmimit të paraqitur nga ne. Në vend të kësaj, AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës një Operator Ekonomik, oferta e të cilit është dukshëm më e shtrenjtë se oferta jonë, pa dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për këtë dallim të konsiderueshëm në çmime.

Si rezultat i këtyre veprimeve, AK po rrezikon të shkaktojë **dëm të konsiderueshëm në buxhetin e Komunës**, pasi oferta e rekomanduar për kontratë rezulton me **çmim total rreth 423 herë, përkatësisht 42,302.00%, më të lartë se oferta jonë.**

Një diferencë e tillë jashtëzakonisht e madhe në çmim kërkon një vlerësim të veçantë, objektiv dhe të arsyetuar nga Autoriteti Kontraktues, veçanërisht kur oferta jonë është shoqëruar me arsyetim dhe sqarime lidhur me strukturën dhe formimin e çmimit. Mos-trajtimi i këtyre sqarimeve, së bashku me mospërputhjen me

praktikën e mëparshme të vetë AK-së, ngre shqetësime serioze lidhur me konsistencën, objektivitetin dhe trajtimin e barabartë të Operatorëve Ekonomikë gjatë procesit të vlerësimit.

Kërkojmë nga OSHP që të marrë në konsideratë pretendimet ankimore në Ankesën tonë, të anulojë Njoftimin B58, ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, të rivlerësojë ofertat duke marrë parasysh faktet dhe argumentet e paraqitura në ankesë, si dhe të shpërblejë me kontratë GOE ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C. & GEOMETRI SH.P.K., në përputhje me kriterin e Dosjes së Tenderit, neni 30.1 – "Çmimi më i ulët me poentim".

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e vendimit të kundërligjshëm të Autoritetit Kontraktues, grupit tonë të operatorëve ekonomikë i është shkaktuar dëm material për shkak të pamundësisë të fitimit dhe realizimit të kontratës, duke humbur të hyrat dhe fitimin e pritshëm për vlerën 350,000.00 € të kontratës, si dhe duke pësuar shpenzime për përgatitjen e ofertës, zhvillimin e procedurës dhe përmbushjen e obligimeve ndaj stafit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë".
- b) Nje kopje te publikimit per "Njoftimin te Vendimit per Dhenies te Kontrates"
- c) Nje kopje te publikimit per "Njoftimin te Vendimit per Eleminim"
- d) Kopje e procesverbalit te Ofertave
- e) Dokumentacion- kopje te fakteve te gjetura

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*